



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

RISHIKIM VENDIMI KESHILLIT BASHKIAK PROJEKT VENDIM

Nr. 37 datë 28.04.2023

Mbi "Dhënien e ndihmës financiare familjes së shtetasit Faik Dan Shegaj i dëmtuar nga djegia e banesës me dt.22.03.2023 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave per vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve," si dhe në shkresën e AKMC Nr. 86/6 dt.27.03.2023" Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" si dhe shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.4234/1 dt.27.03.2023 "Mbi çeljen e fondit të Kushtëzuar për Bashkinë Vau-Dejës" si dhe bazuar në shkresën nr.350/1 dt.15.05.2023 të prefekturës së Qarkut Shkodër "Mbi Vendimin Nr.37, dt.28.04.2023 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Vau - Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë në banesën e tij me dt.22.03.2023 që është banorë i fshatit Melgushë të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë proces verbalin e konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionin e vlerësimit të dëmeve , relacionin teknik të hartuar nga inxhinieri i grupit të punës në vlerën totale **432.347** lekë (katërqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e katërdhjetë e shtatë) për shtetasin **Faik Dan Shegaj** banorë i fshatit Melgushë të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës financiarë për shtetasin **Faik Dan Shegaj** banorë i fshatit Melgushë të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **216.173** lekë (dyqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga zjarri i rënë me dt.22.03.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i cili është miratuar me shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.4234/1 dt.27.03.2023 "Mbi çeljen e fondit të Kushtëzuar për Bashkinë Vau-Dejës.

Konfirmoi bazen ligjore

Krisma Shetani

Konceptoi

Valjeta NIKAJ

Valjeta Nikaj

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

Mark ZHURI



Relacion

Objekti: "Ndërtese (banesë) 1 katëshe me çati në pronësi të **z. Faik Shegaj**

Vendodhja: Fshati Melgushe ,Nj.A, Bushat , Z.K 2644 , Bashkia Vau-Dejes

Bazuar në urdhin e punës të ngritur nga titullari i bashkisë Vau Dejës me nr. 158 datë 06.04.2023, grupi i punës verifikoi gjendjen në banesën e z. Faik Shegaj

Banesa ndodhet në fshatin Melgushe të Njësisë Administrative Bushat , në zonën kadastrale 2644 .Z.Faik Shegaj nuk disponon certifikatë pronësie për këtë objekt, por është në proces legalizimi sipas dokumentit të Drejtorisë Vendore Shkodër me nr.3756 prot. dt.12.04.2023.

Gjatë inspektimit në terren u kryen matjet e dhomës që është djegur ku rezultoi se dhoma ka një sipërfaqe 21.63. m² (sipas planimetrisë bashkëngjitur) , Banesa është e ndërtuar në vitin 1995 e mbuluar me tjegull vendi. Zjarri i rënë ka dëmtuar një nga dhomat e banesës që ishte dhoma gjumi e çiftit ku u dogjen plotësisht të gjitha mobileritë,orenditë që ishin vëndosur aty si dhe dëmtime strukturore të dhomës.

Në vlerësimin e dëmëve të objektit, janë marrë parasysh çmimet e referencës nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe në përzgjedhja e zërave të punës është bërë në mënyrë të tillë, që dhoma të rikthehet në gjendjen e saj fillestare, para se të përfshihej nga zjarri.

Suvatime i brendshem muri 44 m²

Suvatim tavani 17.23 m²

Pragje dritaresh mermeri 1 m²

Veshje me pllake majolike 17.23 m²

Dyer te brendshme 2 m²


Dyer e jashtme e blinduar 3.1 m²

Dritarja e dhomës duralumin 2.8 m²

Lyerje dhome 61.23 m²

Vlera e punimeve ndërtimore është llogaritur bazuar në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të banesave Nr.287 prot dt.14.02.2017

Punoi : Ing. Lazer Gjergji





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 15.06.2023

PREVENTIV PUNIMESH PER RIKONSTRUKSIONIN E DHOMES SË DËMTUAR NGA ZJARRI

Pronari: Faik Shegaj

Demtuar nga Zjarri : 22.03.2023

Nr.	Nr. AN	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	310	Suvatim i brendshem mur tulle llaç i perzier	m2	44	617	27.148
2	300	Suvatim tavani	m2	17,23	914	15.748
3	405/a	Pragje dritaresh mermeri t=2 mm	m2	1,00	3.721	3.721
4	326/a	Veshje me pllaka majolike	m2	17,23	1.989	34.270
5	An	Dyer te brendshme tamburato gjysem xham, veshje me rimoso.	m2	2	12.766	25.532
6	An	Dyer të jashtme te blinduara veshur me rimoso	m2	3,1	19.700	61.070
7	An	F.V. Dritare plastike dopjo xham	m2	2,8	13.776	38.573
8	404/1	Lyerje me boje plastike	m2	61,23	150	9.185
Shuma						215.247

PREVENTIVOI
Lazer Gjergji

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETARI

Mark GJURI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Vau-Dejes, me 15.06.2023

MIRATOHET

KRYETARI
Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

Mark ZHURI



Vlerësimi i dëmeve në mobileri, orendi, pajisje elektroshtëpiake

Në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", vlerësimi i dëmeve sipas komisionit të vlerësimit për: mobileri ,orendi, pajisje elektro-shtëpiake të dëmtuara nga zjarri në objektin e banimit të **z.Faik Dan Shegaj**

Nr	Emertimi	Sasia (copë)	Çmimi	Vlera
1.	Televizor Samsung 32"	1	49.000	49.000
2.	Dhome gjumi matrimoniale	1	155.000	155.000
3.	Dyshek dopio	1	13.100	13.100
Shuma				217.100

Vlerësimi i mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake është bërë në bazë të shkresës Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"

Vlerësimi i zërave të punimeve është bërë në mbështetje të V.K.M Nr. 329, datë 16/05/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli III, pika 2 germa ç, si dhe Udhëzimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, ku vlera e objektit të dëmtuar është **215.247** lekë sipas relacionit të hartuar nga ing.Lazer Gjergji, ndërsa vlera e dëmeve në mobilje, orendi dhe pajisjeve elektroshtëpiake është **217.100** lekë, ku vlera totale e dëmit është **432.347** lekë .

Komisioni:

Valjeta Nikaj

Lazer Gjergji

Ardian Firza



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 37 datë 28.04.2023

Dhënie ndihme financiare familjes së z.Faik Dan Shegaj që i është dëmtuar banesa si pasoje e zjarrit të rene me dt.22.03.2023

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve" si dhe në shkresën e AKMC Nr. 86/6 dt.27.03.2023" Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" dhe shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.4234/1 dt.27.03.2023 "Mbi çeljen e fondit të Kushtëzuar për Bashkinë Vau-Dejës" si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.3 dt.18.04.2023, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Faik Dan Shegaj** banorë i fshatit **Melgushë** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. **Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit të Bashkisë Nr.158 prot dt.06.04.2023 në vlerën totale **923.146** (nëntëqind e njëzet e tre mijë e njëqind e katërdhjetë e gjashtë) lekë për shtetasin Faik Dan Shegaj banorë i fshatit Melgushë të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës .
2. **Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Faik Shegaj** banorë i fshatit **Melgushë** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **461.573** (katërqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e saj me dt.22.03.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit :** Fondi i kushtëzuar i planifikuar në artikullin 604 bazuar në shkresën e AKMC Nr. 86/6 dt.27.03.2023 "Mbi fondin e Kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" si dhe në shkresën e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë Nr.4234/1 dt.27.03.2023 "Mbi çeljen e fondit të Kushtëzuar për Bashkinë Vau-Dejës.
5. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar).

KRYETAR

Mark Bishu

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arden Çelepye


Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.05.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 350/1 prot.

Shkodër, më 5.05.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 37, datë 28.04.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, neni 37, pika 1, shkronja "c", neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "gj", neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të Udhezimit nr. 3, datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016", të shkreses së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 2902 prot., datë 04.05.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.04.2023", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 37, datë 28.04.2023 "Për dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Faik Dan Shegaj që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë me dt. 22.03.2023, sipas Vërtetimit për rënie zjarri të MZSH nr. 3, datë 03.04.2023", me ndihmë financiare z. Faik Dan Shegaj në shumën prej 461.573 lekë, nga programi 3280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", nga buxheti i vitit 2023 të Bashkisë Vau Dejës.

Prefekti ju sjell në vëmendje se Udhezimit Nr. 3, datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016", përdoret në vlerësimin e dëmeve për banesa të shkatërruara plotësisht sipas shkronjës "ç", paragrafi i parë, pika 2, Kreu I, të VKM Nr. 329/2012, ndërsa sipas procesvebaleve bashkëlidhur vendimit si dhe vërtetimit të MZSH, konstatohet se dëmet përfshijnë vetëm një dhomë të banesës së familjes së dëmtuar.

Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon procedim të mëtejshëm, duke zbatuar parashikimet e shkronjës "ç", paragrafi i dytë, pika 2, Kreu I, të VKM Nr.329/2012.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

